



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-560/03-59401 të dates 02.11.2022 të Shoqatës "OMPAK" dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 500 € (pesëqind euro), Organizatës multietnike e personave me aftësi të kufizuara "OMPAK" dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-560/03-59401 të dates 02.11.2022 për realizimin e aktiviteteve të 3 dhjetorit dita ndërkombëtare e PAK-ve për vitin 2022.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së "OMPAKL" dega në Lipjan në nr. 1907946619031150 në BKT bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raport dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu deri me datën 25.12.2022

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata "OMPAKL" dega në Lipjan.

1Nr.560/03-59401
Lipjan, më 04.11.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,770.00€**, (shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-59198 të datës 01.11.2022, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 37 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin tetor të vitit 2022 me nga 210 euro për secilin rast $37 \times 210 = 7,770.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI – dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-59198
Lipjan, më 04.11.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të për projektin Festivali për Fëmijë “Lipjani 2022” Nr.1-453/01-58407 të datës 27.10.2022, Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-453/01-59540 të datës 03.11.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PROJEKTIN FESTIVALI PËR FËMIJË
“LIPJANI 2022”

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **5,000.00 €** (pesëmijë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-në “Evolution Dance” për realizimin e aktiviteteve për projektin Festivali për Fëmijë “Lipjani 2022”, sipas projektit që ka aplikuar në bazë të Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453/01-45965 e datës 23.08.2022,

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna Festivali për Fëmijë “Lipjani 2022”,

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	OJQ-në “Evolution Dance”	5,000.00 €
	Shuma Totale	5,000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2022 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-59540
Lipjan, më 04.11.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400/01-60004 të dates 07.11.2022 të Shoqatës "HANDIKOS" dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **500 €** (pesëqind euro), Shoqata e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara "HANDIKOS" dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-560/03-59401 të dates 02.11.2022 për realizimin e aktiviteteve të 3 dhjetorit dita ndërkombëtare e përsoneve me aftësi të kufizuar për vitin 2022.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së "HANDIKOS" dega në Lipjan në nr. 1907960372031135 në BKT bank.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raport dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu deri me datën 25.12.2022

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata "HANDIKOS" dega në Lipjan.

1Nr.400/01-60004
Lipjan, më 07.11.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400/04-57127 të dates 02.11.2022 të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **500 €** (pesëqind euro), Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/04-57127 të dates 19.10.2022 për realizimin e aktiviteteve të ndryshme me qëllim të funksionimit të zyrës së shoqatës së tyre për vitin 2022.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve dega në Lipjan në nr. 1110270777000187 në Procredit bank.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raport dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu deri me datën 25.12.2022

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve dega në Lipjan.

1Nr.400/04-57127
Lipjan, më 07.11.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 14 Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR BURSAT E
STUDENTEVE

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për vitin akademik 2022/2023, Nr.4-670/01-60226 datë 07.11.2022, në këtë përbërje:

1. Islam Kaleshi, Zyrtar Ligjor në Sektorin për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, Kryesues
2. Fatbardha Shurdhiqi, Zyrtare në Drejtoratin për Infrastruktur, anëtare
3. Albulena Salihu, Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare Nr.4-670/01-60226 datë 07.11.2022 të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për vitin akademik 2022/2023. Komisioni do të shqyrtoj ankesat në bazë Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 si dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-61658
Lipjan, më 15.11.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS TË OJQ-SË PËRFITUESE TË PROJEKTIT FESTIVALI PËR FËMIJË "LIPJANI 2022"

Neni 1

Me këtë Vendim, **Selman Jashanica**, Shef në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës me OJQ-në përfituese për projektin Festivali për Fëmijë " Lipjani 2022".

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratës të OJQ-së si në vijim:

Nr.	Emërtimi i OJQ-së
1.	EVOLUTION DANCE

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 453/01-62164
Lipjan, më 17.11.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare 15Nr.400/01-59178 i datës 31.10.2022 në zbatim të dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës” dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

VENDIM PËT TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Më këtë Vendim, TRANSFEROHET, shuma e mjeteve në vlerë prej prej 3,332.00 € (tre mijë e treqind e tridhjetë dy) euro në zbatim të dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Lipjanit, Obiliqit, Podujevës dhe Prishtinës me Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve me seli në Prishtinë si dhe kërkesës për mbështetje financiare të QMGF dërguar nëpërmjet emailit zyrtar me datë 18.07.2022.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF NGO) në nr.XK051110052260000121 në ProCredit Bank.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

1Nr. 400/01-63274
Lipjan, më 24.11.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 57 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPHNr.06/2019 për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të ndërtimeve, si dhe nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM

I. SHFUQIZOHET, Vendimi 01Nr.020/04-18105 i datës 06.04.2022 me të cilin vendim ishte themeluar Komisioni Punues për shqyrtimin e kërkesave, përkatësisht lëndëve të pranuar nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - DPUMM për trajtimin-legalizimin e ndërtimeve pa leje për objektet e kategorisë së II-të, të cilat nuk janë shtëpi banimi.

II. Përgjegjësia për shqyrtimin e kërkesave për legalizim të objekteve të kategorisë së II kalon ekskluzivisht në DPUMM. Drejtori i Drejtoratit për DPUMM -së bënë organizimin e shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe vendos mekanizmin për kontrollin e shqyrtimit të tyre konform Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

INr. 020/01-63742
Lipjan, më 30.11.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

